

*Shofer/Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.*

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, ligjit nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 141 datë 22.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike”, urdhrin të Kryeministrit nr. 36, datë 19.02.2024 “Për disa ndryshime në urdhrin 233, datë 20.12.2023 ‘Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike’, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Shofer/Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

- Siguron transportin e punonjësve të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, për nevoja të punës;
- Administron dhe përgjigjet për mbajtjen e automjetit në gjendje funksionale;
- Merr në dorëzim automjetin me dokumentacionin përkatës dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tij;
- Respekton destinacionin e lëvizjes së autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK;
- Plotëson fletë-udhëtimet, të firmosura bashkë me personat udhëtues dhe i dorëzon ato periodikisht;
- Kujdeset për cilësinë e punës, kur automjeti ndodhet në shërbime-riparime;
- Ndjek dhe zbaton me rigorozite rregullat e qarkullimit rrugor;
- Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar, me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale.

#### **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDITËT**

**Arsimi:** Niveli minimal diplomës, arsim i mesëm.

**Përvoja:** Të ketë të paktën 10 vite i pajisur me leje drejtimi të klasit B.

- Aftësi të mira komunikuese;
- Të mos jetë i dënuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (III)**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 27.02.2024, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: [burimet.njerezore@cesk.gov.al](mailto:burimet.njerezore@cesk.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV;
- Fotokopje të diplomës;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Vërtetim nga gjykata;
- Raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.